



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 31 maj 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Rregullores Nr. 02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. ____/2023 të datës 23 maj 2023, shpall:

SHPALLJE E BRENDSHME

Për Transferimin e përhershëm të dy (2) prokurorëve të Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

- I. Prokurori i Shtetit mund të transferohet nga Departamenti i Prokurorisë Themelore në Departamentin e Prokurorisë tjetër Themelore të nivelit të njëjtë.
- II. Prokurorët e Shtetit duhet të plotësojnë kriteret për transferim të përhershëm në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, si në vijim:
 - Të jenë prokuror me mandat të përhershëm;
 - Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht vërejtjes jopublike dhe qortimit, përveç nëse transferimi është bërë me vendim të Këshillit Prokurorial të Kosovës si masë disiplinore;
 - Të kenë vlerësim të performancës të mjaftueshëm ose më të lartë.
- III. Komisioni merr parasysh me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm edhe përvojën e punës dhe vendbanimin e kandidatit.
- IV. Me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm merret edhe mendimi i kryeprokurorit të prokurorisë, nga e cila kërkohet transferimi.
- V. Kandidati që aplikon për Transferim të përhershëm, duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit¹ si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://www.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.

- Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
- Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
- Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivist të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

- VI. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
- VII. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 1 qershor 2023 deri më datë 15 qershor 2023.
- VIII. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni në katin e katërt (4) ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj" - Prishtinë, zyra numër 406, të mbyllura në zarf, ose me postë.